

kuar pikërisht të thjeshtëzimi mekanik i veprës.

Procesi i ngjeshjes shfaqet, përkundrazi, si një proces thellësisht krijues. Te «Vitet e para» janë krijuar mjaft ngjarje e situata të reja; p.sh. në vend të dy drejtorëve sabotatorë (në roman), kemi vetëm një (në film), po autorët nuk ecin në rrugën e thjeshtëzimit, të eliminimit a të ngjijtes mekanike, por të shkrirjes së dy figurave, duke krijuar një figurë të re me tiparet e veta individuale. Tek «I teti në bronx» autorët shkuan gjer në kërkimin e një strukture të re kompozicionale, ndryshe nga ajo e romanit, por në të dy rastet e përmendura dhe në të tjera si këto, thelbi i veprave, mendimi i tyre kryesor nuk u çënuar, vetëm se u shfaq në një mënyrë të re, të përshtatshme për ekranin. Ata derdhen në një portret të vetëm dy individualitetet e mëparshme, duke krijuar një të tretë, me individualitetin e vet. Për këtë u desh të krijohen marrëdhënie, ngjarje, situata e tipare individuale të reja dhe vetiu dialog i ri. Po të ecej në rrugën e thjeshtëzimit mekanik, personazhi i ri, vërtet do t'i kishte tiparet esenciale të armikut të klasës, por do të binte menjëherë në sy ngjitja me zamkë dhe nuk do të arrihej kurrësi në individualizimin e figurës.

Arsenali i mjeteve shprehëse që përdor poeti apo shkrimtari prozator për ngjarjen e veprës së vet është vetiu më i madh nga arsenali që ka në dispozicion shkrimtari skenarist. Poeti dhe prozatori përdorin pa kufizim figurat e lindura me imagjinatën e tyre gjatë kontaktit me realitetin e gjallë, skenaristi duhet t'i bëjë ato doemos të kapshme për syrin dhe veshin e spektatorit. Kjo është një tjetër vështirësi objektive në procesin e ekranizimit të veprës letrare.

Përpjekjet për kapërcimin e saj, në veprat tona, kanë qenë të shumta dhe të ndryshme. Kriteri më i sigurtë, ai që ka dhënë fryte të mira, ka qenë gjetja e ekuivalentit kinematografik për mendimin a figurën letrare, në tërësinë e veprës apo në momente të veçanta. Nëse «Cuca e maleve» tingëlloi në ekran me një forcë të re, kjo ndodhi, ndër të tjera, sepse autorët, me mjetet shprehëse të ekranit, arritën të depërtojnë në thellësi të mendimit e të figurës letrare, të frazës muzikore e koreografike. Një detal i pjesshëm nga kjo vepër: gatishmëria e Cucës për të mbrojtur me jetën e vet atë mendim që shprehte të vërtetën e madhe - «Partia na dha lirinë» - shkruar në dërrasën e zezë, në emocionin të gjithëve në teatrin dramatik. Kompozitori krijoi një frazë muzikore të goditur, adeguate me atë mendim, koreografi me mjetet e veta po ashtu, dhe forca emocionale e saj arriti lartësi të

reja. Dukej sikur për kineastët s'kishte mbetur për të bërë gjë tjetër, veç ta filmonin atë. Por ata kërkuan më tej. Kërkuan ekuivalentin kinematografik, dhe, pas mendimit tonë, e gjetën atë si duhet: figurat letrare, muzikore e koreografike tingëljuan me një forcë të re, edhe më të madhe; ato u bënë më konkrete, më të afërta dhe depërtuan e u ngulitën më thellë në rëndjen dhe në zemrën e spektatorit.

Po jo gjithmonë ecet në këtë rrugë. Autorë të ndryshëm ndjekin rrugën e dhënies direkt të asaj që është shkruar e bërë më parë. Në këto raste ndeshim në figura anemike, në letrarizma të panevojshme, të tepërta; ato e humbasin forcën ideoemocionale fillestare dhe, në rastin më të mirë, te spektatori arrin vetëm jehona e tyre e largët. Përse ndodh kjo? Shkaku është po ai: puna për gjetjen e ekuivalentit kinematografik nuk shihet si vepri i krijuar me rëndësi të dorës së parë, ajo zvogëlohet deri në shkurtimin mekanik zakonisht të atyre që autori i veprës letrare i shpreh me ndërhyrjet e veta ose duke ua bërë të njohur se ç'mendime vërtiten në kokën e personazhit në një situatë të dhënë, me çfarë ngjyrash e sheh ai realitetin etj. etj. Harrohet ndonjëherë se, duke hequr mekanikisht p.sh. ndërhyrjen e autorit apo vlerësimin e personazhit ndaj një situatë a ngjarjeje të caktuar, ngjarja apo situata vetë mbeten të xhveshura nga mendimi e ndjenjat, thjeshtohen pra në një varg vepri-mesh të rëndomta me një domethënie të kufizuar, mjaft herë të zbetë.

Në diskutimet tona jo rrallë lind pyetja: «Si i bëhet atëherë? Të futen në film tërë ndërhyrjet e autorit, vlerësimet e tij në formë përgjithësimesh abstrakte?» etj. etj. Një ecuri e tillë do të ishte padyshim zgjidhje krejt e papërshtatshme. Përgjigjen e drejtë e japin veprat më të mira: ato nuk thjeshtëzojnë as nuk sjellin me vete letrarizma të tepërta; ato kërkojnë dhe gjejnë ekuivalentin e domosdoshëm kinematografik.

Disa nga vërejtjet e bëra në shtypin tonë apo nga masa e spektatorëve për ekranizimin e veprave «Toka jonë», «Era dhe hëna» etj. apo edhe për disa vepra të televizionit, vijnë pikërisht për mosgjetjen e saktë të këtij ekuivalenti kinematografik, që de-tyrohem të përmendim kaq shpesh.

Duke pohuar sukseset tona në lëmin e ekranizimeve, njohja e thellë e problemeve, që lindin prej tyre, kërkon një rrahje të gjerë mendimesh, në mënyrë që të përveçsohet sa më mirë përvoja pozitive dhe të zbulohen rrënjët e të metave për t'i luftuar ato.

Në frontin e punës krijuese

Vepra të

reja kritike

Kritiku Razi Brahimi, autor i disa vëllimeve kritike, pas veprës së tij të fundit «Letërsia dhe artet nën dritën e Partisë», e cila fitoi çmimin e parë në konkursin e 30-vjetorit dhe i është dhënë lexuesit, sapo ka dorëzuar për botim një libër tjetër teorik kushtuar problemit të veçorive kombëtare dhe brendisë socialiste të letërsisë dhe të arteve. Problemi është parë i lidhur ngushtë me orientimet e Partisë dhe mësimet e shokut Enver për këtë çështje si dhe me rrugën e kulturës sonë kombëtare.

Gjithashtu, është duke përfunduar «Antologjinë e mendimit marksist-leninist», e cila është një vepër voluminoze. Në të përfshihen mendimet themelore të klasikëve të marksizëm-leninizmit për artin dhe estetikën si dhe kontributi që kanë dhënë udhëheqës e propagandistë të shquar të proletariatit e të marksizëm-leninizmit. Një vend të rëndësishëm në këtë antologji do të zënë materialet e Partisë sonë si dhe mësimet e shokut Enver për problemet themelore të artit dhe edukimit estetik të masave. Në hyrje të librit është një studim i autorit rreth këtij problemi. Të tillë ka edhe në çdo kapitull. Për vitin e ardhshëm ka në plan të dorëzojë një përmbledhje me shkrime kritike të zgjedhura, një pjesë e të cilave janë botuar në shtyp; si dhe një studim teorik për disa probleme të metodës së realizmit socialist.

Muzikë filmi

për fëmijë

Në bisedën që korrespondenti ynë pati me kompozitorin Limos Dizdari mësoi se është duke përfunduar muzikën e filmit për fëmijë «Beni ecën vetë». Ndërkaj ai ka përfunduar një koncert për piano dhe orkestër me motive lirike popullore dhe vazhdon të punojë për simfoninë programatike me disa kohë, ngjarjet

e së cilës fillojnë me luftën dhe përpjekjet e masave popullore për çirimin kombëtar dhe shoqëror që në vitet '30 deri në fitoren e plotë të revolucionit popullor.

Reliev me

temë nga

Lufta

Në studion e skulptorit Dhimo Gogollari korrespondenti ynë mësoi se ai është duke punuar një reliev me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare. Vepra është në përmasa të mëdha dhe tashmë është në fazën përfundimtare.

Në ekspozitën e 30-vjetorit të çlirimit të Atdheut skulptori u paraqit me portretin «Festivalistja», ndërsa në dy ekspozitat e tjera kushtuar Forcave të Kufirit e Policisë Popullore dhe Flotës Luftarake Detare ekspozoi dy portrete; në të parën portretin «Kufitari Vasil Sato» dhe në të dytën portretin «Detari».

Tema

të larmishme

Me temë nga historia e popullit tonë i ka tablotë e tija piktori Pjerin Sheldia. Ato i kushtohen figurave të njohura si Skënderbeut, Bajram Currit etj. Në të ardhshmen ai mendon të punojë një tablo me temë nga fshati dhe portretin e një këngëtarit të njohur popullor.

Piktori Jakup Keraj është duke punuar një tablo kushtuar qëndresës në kampin e Prishtinës dhe një tablo nga Lufta Nacionalçlirimtare. Në planin e tij krijues ai ka edhe një portret të shokut Enver, për të cilin ka filluar nga puna.

Liljana Çefa është duke punuar tablonë «Partizania». Në qëndër të veprës ajo mendon të vendosë figurën e një gruaje gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

Piktori Franc Ashiku është duke punuar një cikël me pllakatë. Ato i kushtohen 35-vjetorit të themelimit të Partisë.

Skulptorët Ashim Kruja dhe Skënder Kraja po punojnë së bashku për një reliev që do të vendoset në shkollën e muzikës në Shkodër. A. Kruja, përveç kësaj, po punon edhe një portret për Dedë Gjo Luin.

Karikaturisti Sutjefën Palushi, përveç disa punimeve që dorëzoi në ekspozitën kombëtare të karikaturës të hapur kohët e fundit në Tiranë, është duke punuar një cikël karikaturash me temë aktuale.

Korresp. i «Dritës»

F. Ballanca: «Pritësit e rrufëve», tregime.

V. Meçaj: «I panjohuri i Rinanit», tregime.

M. Qillari: «Jeta mbi shkëmbin», tregime.

B. Londo: «Krisma dhe trëndafil», poezi.

M. Khaxhiu: «Kritikë e studiimit letrare».

M. Gjini: «Teatri dhe koha»,

L. Qafëzezi: «Poezi të zgjedhura për fëmijë».

Ç. Myftari: «Lundërtari», poemë.

N. Prifti: «Doktor Ariu», përballë.

N. Prifti: «Gara e drerit», përballë.

H. Ulqini: «Kërkuesit e themeleve», novelë.

LETËRSI E HUAJ

M. Gorki: «Për bukën e gojës», roman, ribotim.

F. Glladkov: «Çimentoja», roman, ribotim.

LETËRSI PER FEMIJE

Q. Guranjaku: «Poezi të zgjedhura për fëmijë».